



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.17, datë 27.02.2024

PËR  
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Abaz Muça, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, të caktohet përkohësisht si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
2. Zoti Abaz Muça do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, nga data 27.02.2024 deri më 26.05.2024.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Abaz Muça do të paguhet me pagën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Abaz Muça, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 27.02.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Zeqir Hoda

**ANËTAR**  
**Mirela Bogdani**




**ANËTAR**  
**Moisi Duda**

**ANËTAR**  
**Arta Mandro**

**ANËTAR**  
**Vatë Staka**



**ANËTAR**  
**Ledina Riza**



**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**

